

Shoku im
DORI


Petrit Misa

Milano 2025



Gjyshi.


Teodori ishte gjyshi im nga babai. Kishte lindur më 14/06/1896 në Tiranë, në një familje qytetare të fesë ortodokse ose siç i thoshin ndryshe “llacifac Tirone”. I jati Kosta por edhe gjyshi i tij kishin lindur në Tiranë.



Siç thoshte gjyshi, gjurmët e para të familjes Misa i gjeje në Tiranë që në fillim të shekullin të 19. Thuhet që fillimisht, të parët e familjes, ishin vendosur në qendër të Tiranës (në zonën ku u ndërtua 15 katëshi). Aty kishin ndërtuar edhe kishën e tyre ortodokse. Fillimisht ajo ishte lagja e llacifacëve. Llacifacët ishin punëtorë dhe zanatëçinj të mirë, kështuqë po aty afër ndërtuan edhe

dyqanet e tyre pikërisht në zonën e pazarit të vjetër. Në Pazar gjeje orëndeçës, samarëxhinj, muratorë, bakërxhinj, argjendarë, leshpunues e qeleshexhinj, marangozë etj.

Më vonë, mbasi ishte martuar, gjyshi dhe familja e tij, kishte banuar për një kohë të gjatë në rrugën e Kavajës në një shtëpi të vjetër me qerpiç. Gjyshja Ollga kishte lindur 13 fëmijë, por në kushtet e varfërisë dhe të epidemive të asaj kohe, i kishin rrojtur vetëm 4, nga të cilët më i madhi ishte im atë Klimi dhe me radhë xhaxhaj, Kosta dhe 2 hallet e mija Landa dhe Vali. Në fundin e viteve 50, Xhaxhai im Kosta, përfundoi studimet e larta në Poloni dhe u emërua me punë në



portin e Durrësit.

Kështu gjyshi u shpërngul me banim në Durrës bashkë me xhaxhain dhe hallat.

Ishte akoma koha kur një pjesë e aktiviteteve private ishin të lejuara nga

shteti. Zanati i gjyshit ishte bakërxhi. Riparonte enët prej bakri si tenxhere, kusi, tiganë etj. Në atë kohë, ky ishte zanat i kërkuar, mbasi enët e guzhinës kushtonin, dhe shpesh banorëve ju interesonte riparimi i tyre, kështu gjyshi, me ndihmën edhe të xhaxhait, kishte hapur një dyqan mu në qendër të Durrësit (Pranë ish komitetit egzekutiv).



Me Pushime tek Gjyshi

Ishte viti 1965, Si çdo vit, pushimet e dimrit të shkollës, I kaloja në Durrës pranë familjes së gjyshit. Gjyshi banonte në pallatet pranë hotel vollgës, në afërsi të bregut të detit. Për herë të parë, rrugën me tren Tiranë-Durrës e bëra i pa shoqëruar nga prindërit. Udhëtova nën kujdesin e Medihasë.

Medihaja ishte komshija jonë që jetonte në një shtëpi përdhese pranë pallatit. Dy familjet shkonin shumë mirë. Që i vogël shkoja shpesh në oborrin e tyre dhe luaja me fëmijët e saj që ishin moshatarë me mua. Megjithëse isha rritur, unë e thërrisja akoma “Teta Haja”.

Mami dhe Teta Haja, përshëndeteshin pothuajse çdo mëngjes.

- Gjika, ta shoqëroj unë çunin për në Durrës.
- Për kur e ke në plan Haje?
- Una do nisem këtë të shtunë.
- Shumë mirë Haje, po të lutem ma çoj deri tek pallatet e vollgës ku banon vjehri.
- Po, pa merak

Atë të shtunë, unë mami dhe teta Haja u nisëm për tek treni.

Në hyrje të stacionit vinte era e qofteve të pjekura.

- Prit të të blejë mami panine me qofte për rrugës, - më tha mamaja.
- Haje, a do të të marr edhe për ty?
- Jo, jo. Faleminderit Gjika, una kom bo vezë të skuqura ne djathë.

Atëherë mami i drejtohet qoftexhiut ambulant.

- Shoko, 1 panine me 2 qofte të lutem.

Qoftexhiu, preu një panine për së gjati, futi brënda 2 qofte, I hodhi pak piper të kuq me kripë dhe e mbështjelli me gazetë.

Ndërkohë, me Hajen zumë vënd në një vagon të klasit të dytë.

Në orën 9 treni u nis. Në atë kohë lokomotivat ishin akoma me qymyr guri dhe trenat ecnin shumë ngadalë. Veç kësaj, bëheshin ndalesa të gjata sidomos në stacionet e Vorës dhe të Sukthit. Arritëm në Durrës rreth orës 10.30.

Teta Haja më la në hyrje të shkallës ku banonte gjyshi.

Ardhja ime e gjeti të pa pritur gjyshin. Trokita në derë. Nga brënda dëgjova zërin e halla Landës :

- Kush osht,
- Petriti.
- Kush Petrit.
- Petrit Misa.
- Halla u gëzua. Hapi derën dhe tha. Uuu.. të keqen halla, po si paske ardhur vetëm. Babe, të ka ardh nipi. Gjyshi doli menjëherë te dera.
- Tito, sa më qeke rrit o gjysh, qeke bo burrë. Po flokët ti paska lëpi viçi më duket. – Më tha me shaka.

- Po jo o gjysh, po kështu i kam.
- Hajde këtu të të rroki gjyshi i herë.

Më mori në qafë dhe më shtrëngoi fort. Më pas i bëri zë gjyshes:

- Plake, hec se na ka ardh Titi.
- Kush Tit?
- Titi I Jojës... Nipi jot e plake.

Gjyshja më mori në krah dhe filloi të më puthte pa pushim 5 a 6 herë dhe në të dyja faqet duke folur në gjuhën llaciface:

- Gjini kumeshti?
- Po po, ju përgjegja unë dhe e putha edhe unë në faqe.
- Po sa do na rrish e Tito, më pyet gjyshi.
- Po nja 1 javë, të dielën tjetër këthehem se filloj shkollën.
- Mirë atëherë, gjith këtë javë do të rrish me mu, se gjyshin e ka marrë malli, e kushedi kur takohemi herës tjetër. Nesër do të vish me mu në dyqan. Si thu o Titi i Jojës.
- Mirë gjysho, po pse më thërret Titi i Jojës.
- Sepse je rrit dhe më kujton një shokun tim të fëminisë Titin që ishte çuni i Jojës. Tito, që sot e tutje, je shoku im i ngushtë. Sa e kom pritë këtë ditë që të më bëhesh si shok. Unë do të thërres Titi i Jojës kurse ti më thërrit Dori. Dakord?

- Dakord por vetëm në dyqan. Këtu në shtëpi do të të thërras “Gjysh”.

Landa që nuk ngopej duke më parë më thotë:

- Po sa më qeke rrit o Tito ene je zbukuru pa le. A ke zon ndonji shoqe?

Unë u skuqa nga turpi.

- U më raft pika hallës qi e bona me turp çunin. Mirë, këtë rradhë të ka zonë gjyshi, por kur të vish në verë, je në dispozicionin tim. Do dalim për ditë në plazh ke currilat.
Të du për kavalier.
- Mirë halle do vij,- i thashë.



Dori dhe Titi i Jojës

Të nesërmen në mëngjes, u nisëm për tek dyqani i Dorit. Mbasi hapi qepenin dhe hymë në dyqan, Dori veshi një përparëse të vjetër dhe një palë doreza të trasha, dhe më pas më thotë:

- Si të duket dyqani i Dorit, Tito?

Në fakt dyqani ishte pak rrëmujë.



Mbi tavolinë ishin vendosur shumë vegla pune kurse në tokë ndodheshin tenxhere, kusi të vjetra dhe tiganë të të gjitha llojeve. Unë nuk u përgjigja por Dori ma

kuptoi mendimin:

- Me thonë të drejtën osht pak rrëmujë se kom pas shumë punë këto ditë, por para se të hikim do ta vejmë në rregull.
- Mirë Dori.
- Tito, puna e parë duhet të ndezim zjarrin. A e sheh këtë hunin këtu.

- Po
- Po ta ulish poshtë e ta lëshosh, ky aleti këtu poshtë fryn ajër dhe e mban zjarrin e ndezur. Kjo osht puna jote për sot. Po të ma mbash zjarrin e ndezur, puna bohet më shpejt.
- Mirë Dori- I thashë dhe fillova të bëja levë mbi drurin e fryrësit të zjarrit.



Puna po hecete mirë. Mbasi e ndezëm zjarrin, Dori e mbushi vatrën e punës me qymyr, ndërsa unë vazhdoja ti fryja zjarrit dhe kjo më jepte edhe kënaqësi. Mbas çdo fryrje, flaka ngrihej përpjetë dhe qymyri ndizej duke krijuar shkëndi të shëndritëshme. Ambienti u ngroh shpejt dhe unë hoqa pallton. Kur qymyri u skuq mirë, Dori vuri në zjarr saldatorët e kallait dhe tenxheret që do të kallaiseshin e më pas, filloi të rrihte një nga një tenxheret me çekiq duke i mbajtur me një mashë me bisht të gjatë.

Bakri i zbutur, punoheshe lehtë dhe merte formën e duhur duke mbyllur vrimat ku tenxhwrja ishte shpuar. Më pas gjyshi i ngjiste mirë e mirë me kallaj dhe I fuste në ujë për ti temperuar. Kur tenxherja ishte e ftohur, I provonte në se pikonin dhe, më pas më bënte zë mua:



- Titi I Jojës, nerre kët tenxhere e lene përjashta, aty ku jonë të tjerat, që të kullojë e të thahet.

Më pas tenxheret kalonin në kallaisje. Dori i pastronte mirë e mirë me letër zmerile dhe i lyente me kallaj të shkrirë. Mu duk vetja sikur ndodhesha në një fonderi të vërtetë. Tenxheret e nxira bëheshin si të reja dhe, të lyera me kallaj, shndrisnin si argjënd.

- E Tito, si të duket puna e Dorit.
- E shkëlqyeshme, ashtu si këto tenxheret që po shkëlqejnë tani – i them.



- Do të ta mësoj zanatin, ashtu siç ja mësova edhe Titit të Jojës që punonte si çirak tek dyqani im shumë vjet më parë. Atëherë dyqanin e kisha në Tironë tek pazari i vjetër... dhe vazhdoi me kujtimet e asaj kohe.
- Ndigjo o Titi i Jojës, se e kom me gjithë men. Do bohemi ortakë dhe do fitojmë paret e dynjosë.

Unë nuk fola. Dori e kuptoi që po ngiste më shumë seç duhej dhe shtoi:

- Tito, maro i herë shkollën masanej shif e boj. Vetëm pa zanot mos ngelesh se zanati të jep bukë.
- Po Dori. Një zanat fillova me e mësu që sot.

- Nesër do të të jap të veshësh një përparëse e një palë doreza dhe do të mësosh të përdorësh veglat e punës.
- Mirë Dori- I thashë
- Këtë verë, mbasi të mbarosh shkollën, të vish prapë që të punojmë bashkë.

Gjatë verës, Dori dilte në katundet për rreth dhe mblidhte tiganë dhe tenxhere të vjetra për riparim. E kërkonte dhe e gjente gjithmonë punën.

Nga ora 10 më thotë:

- Tito, tani do bëjmë një pushim se mu lodhe. Do të të jep Dori një dhitshe të kuqe që të blesh një akullore këtu tek Bllaca - dhe më zgjati një bankonotë 10 lekëshe.

Mua mu bë qefi. Bllaca bënte akulloret më të mira në Shqipëri dhe ishte shumë afër me dyqanin e gjyshit. Bleva një akullore të madhe dhe e hëngra gjithë qef deri sa u ktheva përsëri tek dyqani. Vazhduam punën deri sa erdhi koha e drekës.

- Për sot e realizuam planin Tito

Mbasi sistemuam dyqanin, uli qepenin, u këthyem në shtëpi.

Gjyshja na kishte përgatitur një byrek me islla që mu duk shumë i shijshëm.

Fillova të haja me shumë oreks.

- Qeke lodh o Tito më tha Halla, të qeka hap oreksi.
- Jo. I thashë, Dori nuk më la që të lodhem.
- Pse shoku jot osht gjyshi që i thërret Dori.

Unë u skuqa nga turpi por gjyshi më nxori nga situata:

- I kom thonë unë që të më thërrasi Dori, po mos ma ngisni shumë çunin.

Kur erdhi mbrëmja gjyshi më pyeti:

- A di me luft me letra Tito
- Po, luaj nganjëherë me babin
- A bëjmë një 500-she.
- Po, e bëjmë – i thashë.
- O sa mirë tani je shoku i im i punës dhe i lojës.

Gjatë kësaj jave pune me gjyshin mësova shumë gjëra nga zanati i tij, por mbi të gjitha gjyshi më tregoi shumë histori nga jeta e tij.

Disa prej tyre vendosa ti paraqes në këtë libër.



Një italian në Pazar.

Viti 1936. Ishte një ditë e bukur pranvere me diell. Dori me Kostën (të dy llacifacë) kishin hapur qepenë e dyqaneve që në orën 7 dhe po përgatiteshin për pritjen e klientëve. Kosta e kishte më të lehtë, duhet të nxirrte mbi banak topat e pëlhurave të stinës. Ndërkohë Dori dhe Titi i Jojës po përgatishnin hapjen e dyqanit. Duhet të ndiznin zjarrin dhe të përgatishnin tenxheret e parashikuara për tju dorëzuar klientëve atë ditë.



Veç riparimit, Dori shiste edhe enë guzhine që ja binte nga Italia Aristidhi(unë i thërrisja xhaxhi Risti), një nip i tij që merreshe me tregëti, Tregtia me Italinë ishte zhvilluar shumë në atë periudhë.

Mbasi nxori edhe enët në hyrje të dyqanit, doli të priste klientët.

- Mirëmëngjes Çuna – i përsëndeti Shaboni që po hapte qepenin e dyqanit ushqimor përballë. Shabon Qosja ishte tregëtar i njohur në Tironë.

Kishte mbaruar shkollën tregtare në Itali dhe e
njihte mirë zanatin.

- Mirëmëngjes Shabono.
- Dori, si ke gdhi?
- Mirë, desh zoti.
- Nigjo, sot në pazar kena miq prej Taljes.
- Pse Shabe, kush na ka urdhnu.
- Më thanë që osht një gazetar që do me vizitu
pazarin. Nigjo.. thuji ene Kostës që të bojë
sikur nuk di Italisht, se këta gazetarët të bojn
shumë pyetje ene të lojn pa punë, Masanej le
të bojm edhe i çik gallatë me të.
- Mos ki merak Shabono, do të ta çojmë edhe ty
në dyqan.

Nuk vonoi shumë dhe gazetari Italian hyri në Pazar. Si
me porosi ndaloi tek dyqani I Kostës.

- Urdhno zotnia ju. - I tha Kosta dhe I tregoi
stofrat që kishte nxjerrë mbi banak.- Ai don
copa për burra a për gra?
- *Quanto costa questo.*
- Kosta ? Po una jom Kosta. Shi dreqi, po ku më
njuh ti mu qi më qujn Kosta? -

E pyet Kosta dhe i afrohet për ti dhënë dorën.

Italiani qëndroi i habitur nga kjo sjellje dhe i trembur e
pyeti:

- Ma che kosa voi?
- Voj? Ka Shabon Qosja voj- dhe I thërret
Shabanit:
- Shabono, Jepi voj këtij se më ka dal mik.

Shaboni, që e kuptoi lojën, doli nga dyqani dhe i drejtohet italianit:

- Qe lala zotni, çere voji don? - Dhe i bën me dorë Italianit që të futej në dyqan.- Voj lule, voj soje, voj të rafinum. Kemi ene voj qi vjen prej Taljet *olio sasso* me kanoçe.

Gazetari italian nuk po merte vesh se çfarë po ndodhte.

Hyri brënda dyqanit të Shabonit. Shaboni vazhdonte:

- A don voj për sallatë apo do voj për me bo gjellë. Po të dush domate të freskëta për sallatë ti jep lala. - vazhdonte Shabani.
- *Ma che cosa dite?* Pyet italiani që dukej i trembur nga mënyra e sjelljes të këtyre personave të panjohur.
- Ja mre Kost këtu ja, se nuk dashka voj ky, po dashka pite.

Dori e dëgjoi dhe ndërhyri në bisedë:

- Pite..? Ta çojmë ke Xhep Balla Shabono.

Dyqani i Xhep Ballësh ishte në hyrje të pazarit. Xhepi bënte pite të mira me gjalpë, me gjizë ose me kimë.

Shaboni, Kosta dhe Dori e marrin për krahë italianin dhe e çojnë ke Xhep Balla.

- *Ma porca madonna...ma cosa volete da me...*-

Filloi të shante nëpër dhëmbë Italiani.

Hynë në dyqanin e Xhepit. Aroma e këndëshme e piteve sikur e pruri në vehte Italianin, që ju duk sikur nuhati aromën e picave.


- Xhepo, na boj nja 4 pite të mira me kimë.- i thotë Shaboni.

Kur i dhanë piten në dorë, italianit e kuptoj se e gjitha kjo që po i ndodhte, ishte një lojë e sajuar bukur dhe filloi të qeshte me të madhe e ju premtoi se do ta shkruante në gazetë këtë “mikpritje Tironse.”

- *Ragazi, questa ospitalita' lo scrivero nel mio giornale.*

Atëherë Shaboni e falenderoj në emër të grupit me një Italishte të pastër.

- *Grazie e benvenuto a Tirana.*



Dori dhe Shabani.

Mbasi mbaroi tregimin unë e pyeta:

Gjysho po Shabon Qosja është ai që ka një dyqan ka rruga e kjavajës në Tiranë? Mos shtë ai që e ka hundën e madhe dhe e tallin të gjithë.

- Po Tito, për fat të keq ai osht, po nuk e ka pas hundën kaq të madhe dhe nuk e ka tall asnjeri.
- Po pse i është rritur gjysho.
- Nuk e di Tito, kushedi i duket se osht dobësuar dhe I ka dalë në pah, kushedi se osht plak, kushedi se ka vuajtur i shkreti.
- Po pse ka vuajtur. gjysho?
- E kanë pas fut mrena Tito.
- Ku mrena gjusho?
- Në burg e Tit ku tjetër.
- Po pse o gjysh, çfarë bëri i shkreti?
- Nuk boni gjo o gjysh, po ashtu ishte koha atlherë. Mbas çlirimit i kërkun që të dorëzonte në shtet pasurinë që kishte kishte fituar me djersë. Meqënëse nuk e dorëzoi, I vunë tatime të larta dhe mo vonë e futën mrena.

Unë po e dëgjoja.

- Po ti e paske pas shok gjysho?
- Po Tito e kam pas shumë shok dhe me zemër i du të mirën. Kemi qënë moshatarë. Ka qënë 3-4 vjet mo i madh se unë, po shkonim shumë me njoni tjetrin. E kom zonë shok në 1918, sapo ishte kthyer prej Taljes dhe rrinim bashkë. Edhe dyqanet i kishim afër. Me të na ndau vetëm burgu.


Shaboni ra mrena në vitin 47. E dënuan 7 vjet burgim të shkretin. I morën pronat , mallin dhe e bonë “kulak” . Më duket se ka dalë nga burgu në 51 shin. Ishte i marum Tito.

Kur mbaroi dënimin, e kom taku dhe e kom ndihmu sa isha në Tironë, masanaj unë erdha në Durrës dhe e kam taku rrallë. Gjynah, e kishte dëmtu shumë burgu dhe nuk ishte mo ai Shaboni i parë që e respektonin të gjithë si në Talje si këtu në Tironë. Kur vite në dyqpn vite me këmishë e me kallare, I rrumë e I qethun e me kapele republike. Ka qënë zotni burrë Tito dhe ka ndihmu edhe të varfrit.

Si përfundoi kështu as unë nuk e di.

Në atë moment mu kujtuan episode të shëmtuara, ku kisha qënë prezent, kur vinin në lojë Shabanin e shkretë. Dyqani I tij në rrugën e kavajës ishte bërë pika ku çfrynin dufin turmat e tifozëve për ndeshjet e humbura dhe kalimtarët që ju kishte shkuar dita ters dhe që ishin fiksuar se fajin ja u kishte hunda e Shabanit. I bërtisnin me të madhe ” O Shabon o hundë derr”

Historia e Shaban Qoses më kishte mbetur në mëndje që nga biseda me gjyshin. Më kishte ardhur shumë keq për të dhe për tu informuar më mirë, vendosa të lexoja mediat përpara shkrimit të këtij episodi. Aty kuptova se ku e çon njeriun bulizmi publik. Ky njeri i ndershëm dhe fisnik jo vetëm që ishte persekutuar pa të drejtë nga regjimi, por ishte bërë edhe objekt tallesh dhe ofendimesh pa bazë dhe pa arsye. Njerëzit dëfrenin me fatkeqësinë e tij fizike dhe psikike.



Prefekti i Tiranës.

Në bibliotekën e xhaxhait, gjeta një libër që titullohej “Prefekti”. Ishte një komedi e Besim Levonjës, që vinte në lojë ish prefektin e Tiranës Qazim Mulletin. Komedia ishte tërheqëse dhe e shkruar bukur në dialektin Tiranas. Unë e lexoja dhe qeshja me vehte. Nganjëherë edhe me zë. Gjyshi e dëgjoji të qeshurën time dhe më pyeti:

E Tito të ka hik menja?

- Jo gjysho, po kjo që po lexoj qenka shumë e bukur. Të shkrin gazit.
- Ho na e lexo me zo të noltë që të qeshi ene una.

Unë vazhdova leximin me zë të lartë:

- O Qazim more Qazim, Puna jote aferim, Gamor ti gamor kush të vuni, sot a nesër valon druri. Gamor ene fort jom biles deri sa maj kërriçat me vehte..Po keni për të pa ene ju sa të forta jon shqelmat e gamor Qazim Mulletit kur ti përvoni mirë turinit. Mor pluhun kom për tju bo të gjithëve. Të mos ju dëgjohet mo emri as për të mirë e as për të keq. Gjith përfun komve të këtij gamori keni për të hy edepsiza.

- Tito ky që e ka shkrujt ja ka fut kot. Ose nuk e ka njoft, ose e ka pas inat Qazimin. Una Qasimin e kom njoh personalisht Tito. Ka qenë njeri me kulturë qi e deshte shumë Tironën dhe Tironsit.
- Po, i thashë, edhe në libër shkruhet që tironcit I ka dashtë shiko si thotë këtu më poshtë: “Cuni i Hason Hysës me kënu komunikata nëpër shtyllat e telefonit? Po yt atë osht tuxhar i madh mre, ene bashvakët namuz.

Po tët atë e kom mik mër dobiç. Ti mër qetësinë ti prishish nerin Hason Agës. Je ene Tiron, se mos të kishe qenë Tiron, një nishtina kisha për ti hudh trutë në hava.”

- Ti lexoje ene qesh po të dush, por mu, si tiron i vjetër, që e kom njoft Qazimin nuk më vjen me qesh, po me qa.

E ndërpreva leximin sepse gjyshit i erdhi keq që ja kishin sharë Qazimin.

- Gjysho mos u mërzit, këtu e kanë sharë sepse u lidh me fashizmin.
- Qazimi ka dash Tironën dhe tironsit dhe i ka ndihmu edhe në kohën e fashizmit. Osht lidh me Taljonët për të mbrojt tironsit dhe jo për të ndihmu fashizmin.

Kanë kaluar shumë vite që atëherë. Eshtë fundi I vitit 2024 kur unë po shkruaj këto kujtime për gjyshin tim. Në këtë kohë figura e Qazimit është rehabilituar plotësisht dhe Qazim Mulletit i është dhënë titulli “Fisnikëria Tiranase ” mbas vdekjes.

Gjyshi kishte pasur të drejtë për ato që thoshte.





Ahengu Tiranas.

Ishte viti 1976, Atë kohë punoja në kombinatin metalurgjik të Elbasanit dhe kitarën e mbaja gjithmonë me vehte edhe në fund jave.

Shpesh, ditën e shtunë e kaloja në Durrës, sidomos gjatë kohës së verës. Kisha një grup shokësh dhe shoqesh me të cilët shkonja në plazh dhe këndonim deri vonë me kitarë. Për të mos shqetësuar gjyshin, për të fjetur shkoja më shumë tek halla Vali. Halla rrinte zgjuar dhe më priste deri vonë. Vetëm tani që po shkruaj këto rrjeshta e vlerësoj shumë sakrificën që ajo bënte mbasi në atë moshë kitarra, kënga dhe shoqëria, për mua vinin në radhë të parë. Në një nga këto ditë shkova të takoj gjyshin:

- Tito, më thanë që ke filluar me i ra kitarës fort– më tha një ditë gjyshi.
- I bie, po nga pak gjysho, nuk di shumë këngë.
- Ho pra na kno noi kongë.
- Nuk e di a i pëlqen ti gjysho. Janë këngë të huaja. Këngë angleze dhe italiane.
- Na merr ndonji talione te vjeter.

Fillova ti këndoj një këngë të vjetër që e kisha mësuar nga babai.

*“Mamma, mamma, l'altro giorno
Il garzone del fornaio
Ha lasciato pane e forno
Per parlarmi del suo amor...
M'ha baciato sulla faccia
Quel simpatico fornaio
M'ha donato una focaccia
Fatta espressa pel mio cuor”*

https://youtu.be/H-_aCqKAtl

- Yt atë e ka msu prej meje tito.
- A di ndonjë kongë tironse?
- Jo gjysho, nuk di.
- Duhet të mësoh. Osht turp mos me ditë, je ene Tiron.
- Di disa këngë elbasanase të Cuf Myzyrit.
- Haj ta nigjojmë.

Unë fillova të këndoj një këngë që e kisha mësuar nga Bujari, një shok i shkollës:

“O një lulishte me troondafila osht parajsa e vërtet...”

<https://youtu.be/jbl6Rbq8eOE?si=FvDADe5IzK4uDjGq>

Për çudi Gjyshi filloi ta këndonte bashkë me mua. Kishte një zë shumë të bukur dhe ishte shumë i intonuar.

- Gjysho, po ti këndoke shumë bukur. – i thashë

- Pse ti kujton se ke morë vetëm nga jot ëmë (nënë e kisha këngëtare). Ke mor ene nga xhinsi i jonë. I ke ngja ene gjyshit. Ene baba jot osht qefli konge.
- Kur isha i ri o Tito më thërrisnin nëpër dasma sepse këngët tona të Shqipërisë së mesme i dija dhe i këndoja. Ajo kohë ishte kohë lufte dhe mbas orës 10 të darkës kishte shtet-rrethim. Mirëpo unë mersha leje ke Qazim Mulleti për me bo aheng Tirons. Nji ditë i shkova në prefekturë që në mëngjes herët me i kërku leje. Mbajta rradhën përjashta deri sa më lanë me u fut në zyrë.

“Zoti prefekt, kam ardh me mor leje për dasëm.”

“Tirons je tina?”

“Si urno Qazim bej, Tirons jom.”

“Si të qujn?”

“Teodor.”

“Qeke llacifac zotnia jote”

“Po, zoti Prefekt.”

“Ju llacifacët jeni tironca të ndershëm dhe punëtorë.

Po kë marton ti Dori?”

“Una jom ahengxhi Qazim bej, këndoj kongë tironse nëpër dasma.”

“Aaa..Mirë Dori, me qënëse kënon kongë Tironse, lejen e ke në xhep. Vetëm do të dilni në rrugë të nesërmen në mëngjes kur mbaron shtetrrrethimi.”

“Si urno Qazim bej.”

“Ene vrej kshtuna, rregulloni punët me kojshit që mos ju padisin në Polici se masanej më qitni punë mu.”

“Mos ki merak Qazim Bej.”

“Mirë Dori, tani kalo ke sekretari qi të morish lejen.”


- Kështu Tito, Qazimi më jepte nga një copë letër sa herë që kisha dasëm dhe më thoshte.

“ Mos ja daj kongës tironce Dori.”

Me lekët që mblidhja nëpër dasma bleva një fisarmonikë për tët atë dhe i thashë që ta mësojë. Kisha qef që ti binte e ta merja me vehte nëpër dasma. Ai filloi mirë, dhe mësoi disa kongë, por mo vonë erdhën kohë të vështira Tito dhe në kohën e gjermanit, dasmat nuk para bëheshin me aheng.

Kur doli partizan yt atë, e shiti fisarmonikën dhe blevi një palë çizme ushtarake.

Unë e dëgjoja me kureshtje . Desha të mësoja sa më shumë për familjen time, (për xhinsin tim siç thoshte gjyshi).



Kujtimet e familjes.

Mbaj mënd që atë ditë Gjyshi foli gjatë dhe më tregoi shumë gjëra që nuk i dija dhe nuk i kisha dëgjuar as nga babai, ndoshta sepse im atë, e kishte më të vështirë ti largohej pozicionit autoritar të prindit.

- Po në Tiranë kë keni tani Gjyshi?- e pyeta unë.
- Unë nuk kam njerëz të afërt Tito, përvec Aristidhit kurse plaka ka një vëlla e një motër.
- Motrën ja njoh se kemi qënë edhe në dasëm të djalit. Nuk e dija që gjyshja kishte edhe një vëlla.
- Fajin e ka yt atë, Tito që nuk të tregon.

Gjyshi nuk e zgjati muhabetin shumë por unë insistova:

- Po pse nuk flet me dajën e vet babi?
- Me qënëse më je bo burrë i pjekun Tito po ta tregoj, po mos na fut në sherr me tët atë.
- Të jap fjalën Dori.- I thashë duke i thirrur në emër, për ti dhënë më shumë besim.
- Mbas çlirimit të vendit, dajën e babit tat e quajtën kulak e dënuan dhe i morën pasurinë. Që atë ditë yt atë nuk i foli më me gojë.
- Po pse kështu ?

- Kështu ishte koha Tito. Unë me plakën kemi shku me e taku mçeftas babës tat disa herë. Për ne ai ka bo shumë, ka bo pajën e plakës, na ka martu dhe na ka qit në jetë.

Me paret që na dha, blemë shpinë që kishim tek rruga e kavajës dhe ngrejtëm familjen tonë atje.

Siç i kena shku ne mçeftas, le ti shkojë ene ai me e taku mçeftas partisë, se gjaku nuk bohet ujë Tito. Osht njeriu jot. Sot osht nesër nuk osht. Tashti osht ene i sëmurë.

Unë nuk fola se nuk dija çfarë mendimi të jepja Por mendja më rrinte atje tek shqetësimi i gjyshit.

- Gjysho, ma jep lejen që ti them edhe unë 2 fjalë babit. Ndoshta ma dëgjon edhe mua fjalën.
- Mirë Tito vetëm mos na fut në sherr.

I dhashë fjalën dhe e mbajta.

Mbas pak ditësh marëdhënjet me dajën u rregulluan, dhe mua mu bë qefi që kisha kontribuar edhe unë.

- Po babi im, kur ka qënë i ri, si silleshe? A i kam ngjarë unë ndo pak? - e pyeta.
- Kopja e tyt eti je Tito. Yt atë ka qenë i urtë por edhe i vendosur. U bashku me kamunistët si edhe shumë shokë të tij që dolën partizanë dhe bonë hajër, se tani jonë në krye të venit. Ene ky i vogli u bo i hajrit se mbaroi shkollën e tani ka punë të mirë, dhe për të bërë shaka ju drejtua gjyshes:
- He plake, thui Titit çere pune bon Kosti.
- Inxhinier viçash.- u përgjegj gjyshja që nuk e fliste mirë shqipen, ngaqë në shtëpi fliste më

shumë gjuhën llaciface. Deshte të thoshte “inxhinier vinçash”.

Unë dhe gjyshi filluam të qeshim. Në fakt Xhaxhai kishte projektuar vinçat e parë të ngarkim- shkarkimit në portin e Durrësit dhe më vonë ju ngarkuan detyrat e kryeinxhinjerit dhe drejtorit të portit të Durrësit.

- Shyqyr Tito mu bo i hajrit ene ky, se i vogël ka qënë çapkën i modh - dhe më tregoi sa më poshtë...
- E dua shumë xhaxhi Kostin - i thash.
- Po or gjysh ene ai të don.

Duke kujtuar xhaxhain, më erdhën në mend shumë kujtime nga fëmënia ime. kur xhaxhai më merte me vehte në porto, më hypte nëpër anije dhe më tregonte vincat e ngarkim - shkarkimit që kishte projektuar dhe realizuar. Mu kujtua fejesa e tij me vajzën më të bukur të Durrësit, që më vonë u bë një nga njerëzit më të afërt për mua dhe për gruan time. Mu kujtua dasma e tij kur u hapën 2 apartamente për të pritur të gjithë ata të ftuar dhe rakia u derdh si lumë. Unë i thërrisja ne rusisht “djadja”.

dhe ai më përgjigjej “djadja”.

Gjyshi mi ndërpreu mendimet:

- *Xhinsi ngelet xhins Tito.*



Vjedhja e barutit.

Ishte viti 1941. Koha e pushtimit nga fashistët Italianë. Përpara fillimit të vitit shkollor, gjyshit ju propozua një punë në një shkollë fillore në Tiranë. Mbas pushtimit nga fashizmi, puna në dyqan kishte rënë shumë. Veç kësaj gjyshit i mungonin edhe materialet e punës. Atë verë Aristidhi kishte falimentuar me tregëtinë që bënte me Italinë. Italianët i kishin bllokuar mallin në portin e durrësit. Siç kujton gjyshi, Aristidhi kishte ngarkuar në anije një sasi të madhe patatesh, të cilat ishin prishur. Edhe materialet e parashikuar për dyqanin e gjyshit i ishin konfiskuar. Në këto kushte dhe gjyshi e pranoi punën në shkollë, kjo edhe sepse kishte nevojë për një rrogë fikse për të mbajtur familjen. Punonte si bidel. Kujdesej për pastrimin e shkollës dhe i binte ziles të fillimit dhe përfundimit të orarit të mësimi. Sipas rregullit të kohës të gjithë punonjësit e shkollës duhet të paiseshin edhe me divizën fashiste. Edhe gjyshit i kishin dhënë një devizë që duhet ta përdorte gjatë ceremonive të festave në shkollë.

Në atë kohë, xhaxhai im Kosta ishte vetëm 11 vjeç dhe vazhdonte akoma shkollën fillore. Po afrohej dita e krishtlindjeve. Për të festuar festat, kishin përgatitur të

ashtuquajturat “këllcace”,(një paraardhës i fishekzjarrëve të sotëm) të cilat i mbushnin me kokat e shkrepseve për të krijuar një shpërthim të thatë. Dikush nga grupi i shokëve, kishte dhënë idenë që ti mbushnin me barut për të rritur forcën e shpërthimit. Barut nuk kishin, kështu që kishin vënë në plan të vidhnin ndonjë fishek ose predhë në gazermat e italianëve. “ Grupi I morracakëve” siç i thërriste gjyshi, kishin caktuar Kostën që të hynte natën në një depo municioni që ndodhej në periferi të Tiranës.

- Kosta futu ti se je më i vogli.

Edhe po të kapën, nuk të thonë gjë. Ne po bëjmë roje përjashta

- Mirë, po natën nuk mundem se e merr vesh plaku. Po e provoj ditën e diel në mëngjes herët.

Të dielën në mëngjes, Kosta filloi të ndiqte lëvizjet e rojeve të depos. Në fakt të dielave personeli i rojeve ishte i reduktuar. Kosta ishte ishte i imet ne trup dhe shumë i shkathet. Ne ate moshe nuk e njihte as frikën. Gjeti momentin dhe ju ngjit me shpejtësi murit të depos. Hyri në depo pa u diktuar, dhe filloi të kërkonte arkat me fishekë.

Në depo kishte pushkë dhe revole, por nuk po gjente predha dhe fishekë. Ju afrua me kujdes një arke ku kishte predha te kalibrit te madh. U mundua që të hapte kaset shtrënguese që mbanin të mbyllur arken, por hapja e tyre bëri një zhurmë të thatë. Nuk kaloi shumë dhe dëgjoi një zë të fuqishëm.

- *Ferma.... Non ti muovi! Porca madonna, ç'e un bambino qui dentro.*

Kosta e kuptoi që e kishin diktuar dhe ja dha vrapit. Ne ate moment u degjua fuqishem sirena e alarmit. Atehere ju prene gjunjet. Ushtarët e kapën dhe mbasi i dhanë një të rrahur të mirë e çuan në zyrat e komandës.

“Grupi i morracakëve” që e priste përjashta, kur degjuan sirenen e alarmit, ja dhanë vrapit dhe lajmëruan gjyshin se ç’kishte ndodhur. Gjyshi u revoltua, por e mbajti vehten.

- Du te me tregoni nga fillimi deri ne fund çfare ka ndodhur.

Me i madhi i “morracakeve” i shpjegoi fill e per pe ngjarjen. mbasi e degjoi me vemendje, gjyshi u ngrit ne kembe, rrembeu nje shufer deuri dhe ju cfryu:

- He kopila, kopila ma morët në qafë çunin, E gjetet me te voglin dhe mo te urtin. Mos tju shoh mo me te. - ju tha me inat dhe I futi nga një shkop by***ve. Pastaj ju drejtua gjyshes:

- Plake ma boj gati atë kostumin e fashos.

- Ku do me shku o Dori? - E pyeti gjyshja.

Gjyshi nuk ju përgjegj. “ Ene ajo më duhet, ti them se ku po shkoj” mendoi “ qi tja plasi të qames”.

U vesh, u kreh, u rrua dhe doli në rrugë. Ju drejtua gazermave. Në hyrje e ndaluan dhe i kërkuan dokumentet më pas e shoqëruan për në komandë.

- *Comandante, è arrivato il padre del ragazzo.*
- *Farlo entrare.*

Gjyshi hyri brënda. Në shkollë, jo vetëm i kishin dhënë uniformën por i kishin mësuar edhe nderimin fashist. Mendoj që kishte ardhur momenti që ta përdorte dhe e përshëndeti duke ngitur lart krahun e djathtë.

Më pas i shpjegoi se çfarë kishte ndodhur, se çuni i kishte kërkuar pak barut për “këllcacet” e krisht lindjeve por meqënëse nuk mund tja plotësoja dëshirën, me sa duket, kishte vendosur të hynte në depo.

Komandanti po e dëgjonte dhe e shikonte nga koka deri tek këmbët.

Uniforma fashiste, nderimi fashist dhe shpjegimi i gjyshit e bindën, edhe pse femija që kishin kapur nuk kerkonte armatim për partizanet mbasi nuk kishte prekur armet e zjarrit me dore por dhe se predhat 100mm ku po kerkonte nuk i duheshin partizaneve, kështu ju drejtua rojeve:

- *Ma questo e fascista, e uno dei nostri. Lascatelo libero il bambino.* - Urdhëroi komandanti.
- Kështu gjyshi e përfundoi tregimin për Kostën duke mu drejtuar
- Vallahi Tito, e kom ngrejtë për veshësh dhe e kom qit përjashta gazermës. Po i boni mirë. Që atëherë u nda nga “grupi i morracakëve” dhe zuni shokë të mirë të cilët i ka akoma ene sot.



Zanati I babait

Gjyshi, mbasi u mendua pak, vazhdoi tregimin për familjen:

- Kur yt atë mbaroi shkollën fillore, e futa në punë, mos merte ndogjë zanot. Në fillim e çova ke i shoku im, që kishte një berberhone, dhe filloi me mësu berberin. Mirëpo i zoti i berberhones, nuk e lejonte që provat ti bote ke kaptina e klientëve të tij, kështu që bleu një makinë dore për qethje dhe filloi të bote provat tek kaptina e të vëllait .

E mirë..., I vuna një karrige në obor dhe filloi të qethte Kostën. Më pyeti mu:

- Si tja qeth flokët babe.

Unë I thashë:

- Boja tullë, se gjithë shokët i ka morracakë dhe kom frykë mos i njisin morrat.

Yt at nxorri veglat dhe filloi me e qeth. Sapo kishte blerë një makinë dore të përdorur që nuk punonte mirë.



Ja boni tullë gjysmën e kokës. Mirëpo i ngeci makina dhe të vllait ju shkulën flokët me gjithë rrënjë. Kosta u hodh përpjetë nga dhimbjet dhe nuk ja boni të gjatë, i gjujti me gurin e parë që gjeti në oborr, po me aq forcë, saqë edhe sot yt atë e ka shenjën në majë të kokës. Masanej ja dha vrapit nëpër rrugët e Tironës me gjysën e kokës tullë. Lene Tito, filluan tu qesh njerëzit në rrugë. “Grupi I morracakëve” sa e pa, filloji të tallej. Me zor e kom kap me ç’u ke berberi. Qante me të modhe nga dhimbjet dhe nga turpi. Që nga ajo ditë, yt atë nuk qethi mo dhe filloi punën si marangoz ke një Italjon.

- Babe kom zonë punë marangoz. - më thotë.
- Mo mirë marangoz – i thashë- se nuk ke të bosh me kaptinat e miletit. Ke për të qeth dhe për të rrujt drunin. Zanatin e marangozit e mësoi shpejt, mësoi edhe Italishten por aty u lidh edhe me do kamunista dhe mësoi ene gjuhën e tyre. E keqja ishte se mu nuk më tregonte asgjo deri sa një ditë plasi e keqja.
- Çfar ndodhi gjysho?.

Gjyshi e ndërpreu tregimin, mori frymë thellë dhe ju drejtua gjyshes.

- Plake, na bjer ka një gotë ujë mu edhe Titit.

Dukej që emocionet e kishin bllokuar.



Demostrata

Uji që piu, sikur e qetësoi pak dhe vazhdoi tregimin:

- Tito, e mbaj mend si sot, ishte ditë e dile, data 28 nëntor 1943. Yt atë kishte dalë nga shtëpia që në mëngjes herët.

“ Sot kemi festën e flamurit babe dhe do ta festoj me shokët “ më tha “ po u vonova mos u boni merak.”

E kena prit gjithë notën Tito dhe nuk erdhi. Të nesërmen në mëngjes shkova në kuesturë me pyt. Ke dera takova një polic. Ishte një matjan që e njihja që në kohën e Zogut. Sa më pa më pyeti: “A ke ardh për çunin?

“ Xhevato, më thuaj vetëm a osht gjallë.”

“ Vallahi nuk di gjo. Di me të thanë vetëm që i kanë kap, i kanë hi në dru dhe i kanë hip nëpër kampiona. Po nuk e di ku i kanë çu.”

Xhevati ma shtoi edhe shumë merakun dhe shqetësimin. “Po ti kanë çu me i pushkatu?” mendova.

Koha kalonte dhe përpara kuesturës u mbledh gjithë ai millet. Të gjithë prisnin për të marrë vesh noi gjo për fatin e çunave. Më në fund

morëm vesh që i kishin çu në kampin e përqendrimit të Porto Romanos. Në atë moment më erdhi shpirti në vend dhe u ktheva vrap në shtëpi me qetësu plakën. E gjeta me lotë në sy. Sa më pa, filloi të qajë edhe më keq.

“Osht gjallë, ...osht gjallë “ I thash dhe, me thon të drejtën Tito, u preka ene una dhe mu mushën sytë me lot por i thashë vehtes “Maju Dori se burrat nuk qajnë.” Por kët rradhë ishin lot gëzimi që yt atë ishte akoma gjallë.

Në këtë moment gjyshi e ndërpreu fjalën mbasi dalloj lotë në sytë e mij.

- Tito, më fal o gjysh që të preka me këto histori.
- Jo mor gjysh çfarë thua. Unë kam nevojë, që të di sa më shumë nga jeta e njerëzve të mij. Vazhdo të lutem. – i thashë.
- Hajde ke gjyshi të të rroki i herë, - dhe më përqafoi duke më shtrënguar fort e nuk më lëshonte. Mbas pak shtoi :
- Të pastë Gjyshi. Më ke kthyer me mendime 30 vjet përpara kur shtrëngoja fort tët atë dhe falënderoja zotin që ma kishte lonë në jetë.

Megjithatë ato ditë vazhdonim të ishim në siklet e nuk dinim çere të bonim.

Plaka rinte gjith ditën tu qe, kurse mu nuk më merte gjumi i natës.

“Shko o Dori te Qazim Mulleti se mos na e liron. Ai të njeh që je tiron dhe tironcit i ka ndihmu gjithmonë.”

“Po rri o plake rri, se në këtë rrëmujë, Qazimi nuk di ku ka kokën e vet.”

Gjyshi mori frymë thellë dhe vazhdoi:

- A mor Tito, kur të bëhesh babë vetë, atëherë do të më kuptosh. Jeta e babës tat ishte akoma në rrezik dhe, qoftë larg, po ti kishte ndodh gjo do të na ishte ngryisë jeta edhe ne. Desh zoti që nuk i ndodhi gjo.

Ishte data 1 dhjetor 1943. Atë ditë u çume herët dhe u nisëm për në Porto Romano.

Plaka kishte bo nja 2 tava byrek që i morëm me vehte.

Mritëm në Durrës në mesditë dhe që andej vazhduam për në Porto Romano. Pritëm gjatë përjashta se nuk na linin me hy. Mo në fund na e qitën tēt atë. Duket që e kishin rraf keq se me zor hecte dhe fytyrën e kishte të nxime. Plaka sa e pa ja dha të qames . Unë e majta veten.

Siç kujtonte gjyshi aty kishin marë vesh se çfarë kishte ndodhur vërtet. Të rinjtë komunistë kishin organizuar një demonstratë në Tiranë ku ishin hedhur edhe parrulla antifashiste. Kjo demonstratë ndiqte demonstratën e Korçës të 9 shtatorit 1943 ku fashistët kishin vrarë 59 vetë dhe kishin plagosur 120 të tjerë. Gjendja ishte e acaruar.

<https://youtu.be/UHTISinU2N8?si=RwvvHmwyIpV3l28>

—

Demostruesit thërrisnin:

“ Poshtë Fashizmi”, “Rroftë Shqipëria e lirë”. Të rinjtë e shoqatës së marangozëve po i afroheshin bashkisë. Yt atë ishte në mes të tyre. Mbas dite ishte dhënë urdhni që të shpërndahej demonstrata me forcë dhe Policia kishte sulmuar demonstruesit me shkopinj e bajoneta. Më të rrezikshmit i kishin kapur, i kishin lidhur dhe i kishin hypur nëpër kamiona. Mirë që nuk shtinë me armë si në Korçë se do ishte bo kasaphone.

Ishte koha e kapitullimit të Italisë në luftën e dytë botërore. Fashistët ishin tërbuar nga kjo situatë e kishi shtuar terrorin. Asnjë gjëje nuk i dihej.

Në kampin e përqendrimit të Porto Romanos, të dënuarit i mbanin vetëm me bukë e me ujë. Kishin vendosur ti internonin në Itali por anijet nga Italia nuk po vinin.

Duke përfunduar këtë kujtim, gjyshi mori frymë thellë dhe tha:

- Desh zoti Tito, që nuk i majtën shumë dhe i liruan para vitit të ri. Italianët ja mbathën se kishin frykë gjermanin dhe e lanë kampin pa roje.
- Mu më lajmëroi një nga fisi Nishku, një llacifac tirone dhe shok I babës tand. Më erdhi në shtëpi dhe më tha kshtu, kështu puna. Plaka u bo merak, filloi prap me qa dhe më thotë: “ Dori nisemi shpejt se na ka ngel çuni rrugash.”



Lajmi i braktisjes së kampit nga Italianët u përhap me shpejtësi në Tiranë. Të nesërmen u grumbulluan në dalje të Tiranës një grup i madh njerëzish. Gjetëm një kamion për në Durrës dhe u nisëm. Babën tat e gjetëm akoma në kamp. Ishte i marum, por i lumtur që e kishin liru dhe që po takohej me ne. *Liria osht gjo e modhe Tito.*



Dori dhe Partizanët.

Dori ishte patriot, siç deshte Tiranën deshte gjithë shqipërrinë, por nuk e njhte dhe nuk e kuptonte as ideologjinë komuniste dhe as atë fashiste. Kur im atë I thoshte që fashistët Italianë na kanë pushtuar vendin, ai dilte kundër fashistëve dhe bëheshe më antifashist se im atë.

Unë u pasionova pas historive që tregonte gjyshi atë ditë dhe ju luta të vazhdonte.

- Po pastaj babi doli partizan?

Jo ka dalë partizan në pranverën e vitit 1944. Në atë kohë yt atë ishte ilegal, e nuk rrite dot mo në qytet.

- Po pse gjysho? - E pyeta.

- A e njeh Vangjelin, shokun e babit tat ?

- Po

- Nje me atë kon dalë në mal. Vangjeli e kishte fut në valle që përpara tët atë. Në fillim i jepte me shpërnda trakte, më vonë edhe materiale për partizanët. Una e kisha mor vesh, por nuk ndihesha.

Vangjeli isht çun i mirë dhe unë e desha fort, si fëmijën tim. Ishin shumë shokë me tët atë.

E maj mend si tani, ishte muaji maj. Në derë troket Vangjeli.

“Babe, mos i boj merak se Klimi do vonohet sot.”

“Pse mër babë, ça ka bo vaki,”

“E kan kap du dalë jashtë Tirone dhe e kanë çu në polici për kontroll.”

Mu sa s’më ra pika, u bona helm dhe me zor mbahesha në komë. Për fat në darkë vonë djali mu kthy në shpi.

Gjyshi ma tregoi me imtësi ndodhinë e asaj dite

Vangjeli ishte partizan në brigadën e 3-të sulmuese dhe zbriste nganjëherë në Tiranë për të organizuar klandestinët.

Atë ditë, im atë duhej ti dorëzonte në periferi të Tiranës një top pëlhere që do të përdorej për të qepur rroba ushtarake për partizanët. E kishte ngarkuar topin e stofës në biçikletë dhe po dilte nga rruga e Dibrës. Një patrullë e policisë e ndaloi dhe i kërkoi dokumentet. Më pas e shoqëruan në policinë e Tiranës, e cila ndodhej në zonën ku sot është blloku. E morën menjëherë në pyetje.

- Emër, mbiemër, emri i babës, adresa e banimit.

Babi i ishte përgjigjur të gjitha pyetjeve.

Më pas filluan pyetjet më të vështira por Vangjeli ja kishte përgatitur të gjitha përgjigjet që duhet të thoshte po ta kapnin.

- Për ku po e çoje stofin ?

Babai i tha përgjigjen që e kishte mësuar përmendësh.

Me sa duket policët nuk e kishin besuar dhe filluan ta rrihnin. E futën në një dhomë katrore ku qëndronin 4 policë. Një polic për faqe muri. Çdo njëri e godiste me forcë dhe ja pasonte tjetrit. Kjo metodë u përsërit derisa babit i ra të fikët. E prunë në vehte duke i hedhur ujë dhe vazhduan pyetjet:

- Ku po e çoje stofin?

Babi përsëriste të njëjtën përgjigje që i kishte dhënë më parë. Atëherë rrahja bëheshe gjithmonë më e rëndë. Kur i ra të fikët për herën e dytë, policët e hodhën në një birucë dhe e lanë në errësirë. Mbasi erdhi në vehte, ndjeu që i dhimte i gjithë trupi nga plagët, por i dha vehtes dhe u ngrit në këmbë. Ju kujtua që me vehte kishte një dokument të rëndësishëm që nuk duhet të binte në dorë të gjermanëve. E kishte fshehur në mëngët e këmishës. Duke i palosur mëngët, dokumenti nuk binte në sy. Për fat nuk i kishin bërë kontroll të imët dhe dokumenti ishte akoma i fshehur. Ju afrua derës dhe i kërkoi rojes që të shkonte në banjë. Aty e grisi dokumentin në copa të vogla dhe e hodhi në wc. Bashkë me shkarkimin e ujit të w.c. së ju shkarkua edhe atij ankthi imadh që e kishte përfshirë. Për fat kontrolli kishte përfunduar me kaq dhe babain e kishin liruar.

- Nga ajo ditë, yt atë nuk mund të rrite mo në Tironë Tito, sepse ishte në rrezik. Shokët I kërkun që të dilte në mal.
- Babe – më tha - duhet të dal partizan.
- Si të jetë shkru o bab, shko me shokët po ruaj vehten. - I thashë me zemrën e ngrime dhe kom lut zotin të ma kthente të gjallë nga lufta.

Mu kthy vonë, sepse kishin luftu edhe për çlirimin e Kosovës por ishte shnosh e mirë, shyqyr zotit.



Besimi

Dori ishte besimtar por jo praktikant. Gjatë kohës kur feja ishte akoma e lejuar, nuk më kujtohet të shkonte ndonjëherë në kishë dhe as të luteshe në shtëpi, megjithatë i këshillonte edhe gjyshen edhe hallat e mija që të shkonin në kishë dhe të faleshin edhe për të. Megjithatë një ditë ja mbushën mëndjen që të shkonte bashkë me familjen si pelegrin në kishën e Shënavlashit që ndodhej në afërsi të Durrësit. Ishin ditët e pashkës dhe kishin vendosur që të premtën dhe shtunën të flinin

në kishë dhe të dielën të bënin një piknik në rrethinat e kishës, në një ambient piktoresk dhe të gjelbëruar.

- Hikni ju, hikni se unë po rri në shpi. - I tha Landës.
- Po ku të shkojmë ne e babe, tre gra vetëm.
- Mire e di çke ti Shko e ma merr Titin në Tiranë. Du që të vijë edhe ai me ne.

Fjala e gjyshit nuk vihej në diskutim. U aktivizuan të gjithë.

Atë të enjte bie telefoni dhe nëna më thotë se do të shkoj tek gjyshi në Durrës për pashkë. Të nesërmen në mëngjes, në shtëpi na vjen halla Landa. Nëna më kishte përgatitur një valixhe të vogël me 2 palë ndërresa që do ti merja me vehte. U nisëm menjëherë me hallën dhe në kohën e drekës ishim në Durrës. Më kujtohet që pjesën më të madhe të rrugës për në Shënavlash e bëmë në këmbë. Arritëm në mbrëmje vonë. Salla e kishës ishte plot me njerës.

- Tito, u lodhe o gjysh?
- Pak gjyshi.
- Mirë, shtriu këtu afër gjyshit dhe fli pak.

U shtriva në një nga stolat e kishës, mbështeta kokën në prehrin e gjyshit dhe gjumi më zuri menjëherë. Nuk e di për sa kohë fjeta por u zgjova nga zërat e njerëzve. Të gjithë mbanin në dorë nga një qiri të ndezur dhe pëshpërisnin “ Krishti u ngjall, Krishti u ngjall..”

- Çfarë po ndodh gjyshi?
- Sh..t. duhet të thuash ”Krishti u ngjall”. Të gjithë bënin kryqin dhe thoshin “ Krishti u

ngjall”. U bashkova edhe me ta dhe, për herë të parë në jetën time, bëra kryqin edhe unë.

Gjyshi më shikonte dhe dukej i kënaqur që edhe unë po bëja hapat e para në rrugën e besimit.

- Gjyshi, po në atë dhomën aty çfarë bëhet.
- Aty Tito, shkojnë njerëzit për tju jutur Shën vlashit. Unë them që të shkosh edhe ti bësh edhe ti një lutje.
- Nuk di çfarë lutje ti boj gjysho.
- Menoje vet Tito. Kërkoji një gjo që e ke për zemër.

Ju afrova dhomës së shenjtorit dhe po ndiqja sjelljen e njerëzve të tjerë që ishin brënda. U ula edhe unë në gjunjë dhe po mendoja çfarë ti kërkoja. Mëndja më shkoi tek njeriu më i afërt, tek nëna ime, që në atë kohë vuante nga tiroidet dhe u luta me zë të ulët “ Shën vlashi, ma shëro nënën nga tiroidet”. Mbas lutjes u ktheva tek gjyshi që dukej i lumtur:

- Tito, ja ke bo qefin gjyshit dhe që sot je “rob zoti”.

Ishte hera e parë dhe e fundit që shkoja dhe falesha në kishë. Më vonë nuk pata asnjë shtytje për të kultivuar besimin, si nga familja dhe nga as nga regjimi i kohës,(që i mbylli edhe vendet e kultit),



Plaka

Për sa e kujtoj gjyshin, nuk mbaj mënd që ai ta thërriste gjyshen me emër. Gjithmonë i thërriste “ plaka”. Në pamje të parë mund të duket si mungesë respekti për gruan, por të gjithë ne të shtëpisë e dinim mirë se sa e deshte gruan ai.

Këto ditë, duke shkruar librin, fola në telefon me motrën, Arianën, që banon në Amerikë. Ajo më solli ndër mend këtë një rast kur gjyshi na erdhi për vizitë në shtëpi.

Sa hyri në derë ju drejtua mamit:

- Meqënëse më keni ftu 100 herë dhe nuk ju kom ardhë, këtë rradhë kom ardhë me ndejt ca kohë me ju.
- Po ti të rrish sa të duash babe dhe mos e ki merak se na bëhet qefi e nuk na bëhesh barrë për asgjë.
- Mirë Gjika po rri nja një javë.

Pastaj mu drejtua mua:

- Si thu ti Tito, a të rri kët javë me ty.

- Unë dua që të rrish gjithmonë me mua gjysho.
E pashë që u prek nga fjalët e mia.

- O të pastë Gjyshi, më kishte marrë malli për ju.

U munduam që ti krijonim kushtet e duhura që të mos mërzitej. Mami filloi ti gatuante gjëra të shijshme. Unë I rrija pranë dhe e ftoja që të bënim ndonjë dorë me letra. Atë ditë babai u këthye nga puna me një shishe raki të zgjedhur dhe u shtrua për nder të tij një darkë speciale.

Kështu dita e parë kaloi mirë dhe ishim të kënaqur nga prezenca e tij. Por të nesërmen në mëngjes, i drejtohet mamit dhe i thotë:

- Gjika, una nesër në mëngjes du me u kthy në shtëpi.
- Po pse, babe çfarë ka bërë vaki. Të mungon ndonjë gjë.
- Mos tju vijë keq. Ju du fort të gjithëve, por më ka marrë malli për plakën.

Nuk mund ti thonim asnjë fjalë. U mundova ta imagjinoja se çfarë ndjente ai për gjyshen e cila i kishte kushtuar jetën atij, kishte përballuar 13 lindje dhe kishte rritur me plot mundime 4 fëmijët e mbetur në jetë. Nuk ishte ndarë prej saj asnjë ditë dhe deshte ta kishte pranë në çdo moment.

- Herën tjetër ta marrësh me vehte edhe plakën - i tha mami - që të rrini më shumë.

Të nesërmen që në mëngjes, e përcolla gjyshin deri tek treni.

- Gjyshi, mirupafshim dhe të fala gjyshes.

E pashë që u prek por nuk foli. Ma bëri me dorë,
ndërkohë që treni u nis.

- *Do ta puth plakën edhe nga ana jote Tito.*



Ditëlindja e Gjyshit

Ishte viti 1966. Gjyshi kishte Ditëlindjen po nuk e mbante mënd sepse nuk e festonte asnjëherë. Por atë ditë djemtë e tij babai im dhe xhaxhai ishin kujtuar që kishte 70 vjetorin dhe kishin vendosur tja festonin.

Mbaj mënd që u nisëm me tren në orët e mesditës. Unë kisha marrë edhe kitaren me vete.

- Babi, pse po ku do ta festojmë?
- Tek shtëpia e xhaxhi Kostit – më thotë babai.
- Po jemi shumë.
- Jo, jo ne të tre edhe gjyshi. Gratë i kemi lënë nëpër shtëpija.
- Po pse kështu?
Po ja, gjyshi ka qef që të mblidhemi vetëm ne burrat, dhe ti e di që ai të konsideron ty burrë.
- Po më ka si shok. Edhe unë e dua shumë babi – i them

E pashë që babin ju bë qefi, por nuk foli.

Arritëm tek shtëpia e xhaxhait rreth orës 5 mbas dite. Gjyshi me xhaxhain na prisnin me tavolinën plot.

-Hajde Titi i Jojës ulu këtu afër Dorit se sot do të këndojmë bashkë me kitarë. A ja ke ngref telat mirë o gjysh.

- Po po

Mua mu bë qefi dhe zura vend pranë tij. Mbasi mbaruan biset e përditshme, ja filloi kënga.

Shijet muzikore ja dija të treve.

Për gjyshin këndova këngën

“ Një lulishte me trëndafila,”

Babit i pëlqente “ spaske pas një pik mëshire.” Kurse xhaxhi Kostë nuk kishte preferenca, kështu që i këndova këngën “ vija deti mi lalë o tallaz tallaze”

Si fillim ishte mirë, por edhe shumë këngë të Shqipërisë së mesme nuk dija, kështu që vazhdova me këngë Korçare të cilat i dinim të gjithë. Këndonim dhe pinim raki. Nuk i muar vesh në se pija shoqëronte këngën apo kënga shoqëronte pijen. Si përfundim të gjithë erdhëm në qef. Gjyshi ishte më i rezervuar nga të gjithë. Aty nga mesi i natës më thotë:

- Tito a puna kap ndonjë këngë partizane, se du me kujtu kohën e luftës.

Atëherë formova një akord në kitarë dhe fillova:

- Partizani në luftë po shkonte,, mori pushkën me një dor....

Lamtumir moj nënë e babë lamtumir moj motër e re..

Babi dhe xhaxhi Kostë qëndruan si të habitur dhe nuk po këndonin. Nuk po e kuptonin se ku deshe të dilte gjyshi me këtë iniciativë.

- Ho pra partizanë. Kënoni pse nuk po këndon. Me këto këngë në gojë na çliruat dhe na sollët lirinë.
- Po babe, edhe ti ke qenë me ne- i tha babi
- Po, me ju kom qenë o bab derisa luftuat armikun, por nuk jam me ju kur luftoni mikun Ky shteti juaj ju ka dënuar dajën tuaj dhe e ka quajtur armik, ja ka morë të gjitha napolonat e floririt dhe e ka fut ene mrena. Si përfundim ju keni frykë me e taku dajën tuaj. Po kështu ka dënuar ene Shabonin, shokun tim të rinisë.
- Babe paske pi një çikë i shumë, o babe.
Gjyshi mu drejtua mua.:
Tito, vazhdojmë me klongë kundër fashizmit:
- *Nuk i durojmë, nuk I durojmë gjithë këto mizoria, gjithë këto shtypje ne kto poshtërsina, nuk I durojmë jo... gjithë këto mizoria..*
- Babe, po mos bërtit o bab, - i tha xhaxhi Kost, - se na nigjojnë komshijtë.
- Po le të na ndëgjojnë. A i keni kënduar këto këngë nëpër demonstrata kundër fashizmit pse keni frykë me i këndu tani.
Gjyshi vazhdonte ti binte me forcë tavolinës duke mbajtur ritmin e këngës:
“ *Nuk i durojmë, jo, gjithë këto mizoria, gjithë kto shtypje dhe kto poshtërsina..*
Dashur pa dashur filluam të këndonim të gjithë..



Skuadra e zemrës.

Gjyshi ishte tifoz i madh i skuadrës së futbollit të Tiranës. Aq shumë e kishte në zemër skuadrën sa nuk linde ndeshje pa parë dhe bënte shumë tifozllëk aq sa shokët i thonin “Je valutë e Tironës”. E ndiqte skuadrën edhe nëpër rrethe. Lojtarët i njihte personalisht.

Një ditë më pyet:

- Tito, më kë skuadër je tifoz?
- Me Partizanin.

E pashë që ngeli keq.

- Fajin e ka yt atë – më tha që mas çlirimit u bo me Partizanin ne e harroi Tironën.

Nigjo Tito, kët të djelë do shkojmë bashkë në stadium të shohim Tironën. Luan Tirona me Durrësin.

- Mirë Dori, shkojmë, i thashë.

Mbasi hëngrëm drekë, u nisëm për në stadiumin e Durrësit. Gjyshi blevi 2 bileta 10 lekëshe dhe zumë vënd në shkallët anësore të stadiumit.

Ndeshja e asaj të djele ishte e ftohtë dhe pa emocione. Përfundoi në barazim 0 me 0.

Dori u mërzit.

- Nuk osht tirona e rinisë time. Tjetër futboll luheshe atëhere Tito. Kishte mo pak skuadra dhe mo shumë lojtarë të mirë.

Pastaj më spjegoi që në kategorinë e parë luanin vetëm 4 skuadra dhe se 8 kampionatet e futbollit para lufte, 7 i kishte fituar Sport Klub Tirona dhe vetëm 1 e kishte fituar Vëllazëria e Shkodrës që ishte edhe skuadra më e vjetër e futbollit Shqiptar.

- Të bohesh me Tironën si gjyshi jot.
- Do bëhem me tironën se të kam xhan, por jo tifoz si ty
- Ashtu të pastë gjyshi. Ne fund të funit, ti nuk ke nevojë me dalë partizan si yt atë.

Ishte viti 1976, Ndodhesha në Shkodër në një ceremoni varrimi. Kishte ndërruar jetë në moshën 105 vjeçare Cani, gjyshi i të fejuarës time. Ishin grumbulluar shumë njerës, farefis dhe shokë të të ndjerit. Aty hyra në bisedë me Dylin një burrë i moshuar në moshën e gjyshit tim. Dyli u bë kurioz nga mbiemri im dhe më pyeti:

- Çfar e ke Dorin.
- Dori është gjyshi im i thashë.
- Po ti çfar po thu he burrë. Unë gjyshin tand e kam mik dhe shok të vjetër.
- Po ku jeni njohur i thashë, ti në Shkodër ai në Tiranë.
- Na kanë lidh skuadrat e zemrës.- më tha Dyli - dhe më tregoi si ishin njohur me Dorin.

Dyli ishte, sikurse edhe Dori, ishte “valutë” e skuadrës Shkodrane të futbollit dhe e ndiqte skuadrën në të gjitha ndeshjet brënda dhe jashtë Shkodrës. Në kujtimet e Dylit

kishte mbetur në mëndje ndeshja e futbollit midis Tiranës dhe Shkodrës e zhvilluar në Tiranë në vitin 1940.

Dyli kujtonte:

- Atë ditë ishin nisur që në mëngjes me kamion bashkë me disa tifozë të tjerë.
- Me thënë të drejtën ato vite Tirana kishte lojtarë më të mirë dhe fitonte shpesh kundra nesh. Por këtë rradhë kishim besim që do të fitonim edhe sepse Tiranës i mungonin 2 lojtarët më të mirë Lushtra dhe Kryeziu që, atë vit, luanin në Itali me skuadrat e Barit dhe të Romës. Kishim marrë me vehte edhe një orkestër të vogël për tja marrë këngës Shkodrane në stadium.

Rreth orës 2 hymë në fushën e Shallvares në Tiranë ku do të zhvillohej ndeshja. Dori kishte ardhur përpara nesh dhe kishte zënë vënd në qëndër të shkallëve të stadiumit. E njihnim mirë siç na njihte mirë edhe ai, por nuk kishim muhabet me të. Si gjithmonë kishte marrë me vehte disa këmishë të vjetra e të grisura, të cilave ju vinte flakën sa herë që Tirana bënte gol.

Sapo filloi loja ne ja filluam kanges Shkodrane.

Mirëpo kënga jonë nuk vazhdoi shumë. Tirana hidhet në sulm dhe shënon gol që në minutat e para. Stadiumi oshëtiu nga thirjejt e tifozëve të Tiranës. Dori u ngrit në këmbë , dogji këmishën e parë dhe filloi të bënte tym e të bërtiste “ Tirona, Tirona..”

Grupi Jonë qëndronte I heshtur dhe nuk ndiheshe.

Nuk kaluan as 10 minuta dhe Tirana shënon golin e dytë.

Dori nuk duroi më, nxori këmishën e dytë dhe I vuni flakën. Festa e Dorit vazhdoi edhe gjatë pushimit

U afrua tek grupi jonë dhe vazhdonte të rrotullonte këmishën duke kërcyer e duke na u drejtuar ne “ O vllazni shko në shpi, o vllazni shko në shpi”.

Mbas pushimit, tranieri jonë ndryshoi 2 lojtarë dhe loja mori pamje tjetër.

Në pjesën e dytë skuadra jonë shënoi 2 gola njëri mbas tjetrit dhe ndeshja përfundoi në barazim 2 :2.

Mbas golit tonë të dytë, Dori nuk u ndie më dhe doli fshehurazi nga stadiumi. Mirëpo ne ja dinim shtëpinë dhe i shkuam në shtëpi me këngë e me lodra.

Mbaj mend që i kënduam këngën “2 dele 300 pare”

https://youtu.be/Nw_RV_LDPqY?si=yWyzIB2rE38DgQDh

me fjalët e ndryshuara:

“Dy gola dy gola, ktu ne Tirane

Dy gola dy gola, ktu ne Tirane

Dil o Dori, Dil o Dori, na kap një valle,...

Marshalla, marshalla, sa të paska hije

Si bakllava si bakllava ne tepsie....”

Atë ditë njoha edhe shpirtin e bardhë të gjyshit tënd. Doli në rrugë dhe na ftoi në shtëpi. Na nxori nga një gotë raki dhe filloi të këndonte bashkë me ne. Këndonte bukur dhe dinte edhe këngë shkodrane. Që atë ditë u bëmë miq të mirë dhe sa herë vinte në Shkodër për të ndjekur skuadrën e Tiranës e ftonim edhe ne në shtëpi.

Kur takova gjyshin ja tregova takimin tim me Dylin. Ju bë qefi dhe shtoi:

- Sa herë që të shkosh në Shkodër ti bësh të fala Dylit nga ana ime. Shkodranët janë njerës të mirë dhe mu më bohet shumë qefi që je lidh me Shkodranë Tito.

Kështu xhinsi jonë shkon përpara.



Dori në dasmën time

Një nga ëndrrat e çdo gjyshi është të arrijë të martojë nipin apo mbesën e tij.

Në kohët moderne kjo ëndër është bërë shumë e vështirë për tu realizuar. Kjo sepse me kalimin e kohës martesat bëhen gjithmonë e më të vonshme.

Të rinjtë e sotëm duan më parë të bëjnë eksperiencat e tyre paramartësore. Më pas duan të krijojnë kushtet materiale për të siguruar ritjen e fëmijës dhe kështu lindja e fëmijës shtyhet e shtyhet sq sa gjyshërit e sotëm e kanë të vështirë të arrijnë që të gëzojnë dasmat e nipërve të tyre.

Po mendoj veten time. Kam 3 nipa (Enea, Kamil dhe Elian) dhe një mbesë (Bianka). Më i madhi, Enea është 9 vjeç kurse unë 73. Po u martua siç janë martuar prindërit e tij (mbi 35 vjeç), unë duhet të jem rreth 100 vjeç. Kështu që dasmën e nipërve nuk do ta gëzoj dot.

Dori ishte me fat që jetoi për dasmën time. Kishte 7 nipra dhe mbesa dhe i deshte të gjithë njësoj, por unë isha më i madhi nga të gjithë dhe kisha diferencë moshe nga të tjerët.

- Tito unë dasmën tande do ta haj se s'bon. Jo vetëm që do të rroj por prej qefit do të kërcej ashtu mo...
- Si gjysho ?
- Do kërcej ashtu mo lisho... pa brekë.

Unë qeshja. Më shikonte dhe fillonte edhe ai të qeshurën.

- Këta të tjerët janë të vegjël Tito, nuk besoj që të arrij deri në dasmën e tyre.
- Po do rrosh o gjysh do bëhesh 100 vjeç.
- Të lumtë goja Tito, të më rrosh ti, të keqen Gjyshi.

Ndodhi ajo që ndjente zemra e gjyshit. Ishte 28 korriku i vitit 1979. Ishte dita e dasmës time. Ishte ditë e shtunë dhe familja e nuses kishte organizuar darkën e dasmës. Kishin zgjedhur një sallë të madhe tek godina e Medresesë. Dori ishte i pari në listën e të ftuarve. Si më i vjetri e vumë në krye të tavolinës, por nuk qëndroi gjatë i ulur. U çua në këmbë dhe ja mori valles. Pastaj mu afrua mua dhe duke hequr xhaketën e kostumit më tha: - Të tjerat nuk po i hek Tito se do të më marrin për të marrë.

- Hiq çfar të duash gjysho, se ty nuk të thotë gjo njeri ty.- I thashë

Filluam të qeshnim dhe vazhduam vallen. Kishte qef të kërcente dhe merte në kërcim gratë dhe vajzat e reja.

- Jemi xhins qefli ne Tito, po edhe këto mo, qenkan xhins i bukur vërtet. Ke dit ku me gjujt.

Aty rreth mesnatës erdhi radha e valles së çiftit.
Shkodranët ja morën këngës:

“Sa bukur na ka dal nusja, marshalla, marshalla
E bukur për bukurie,
marshalla, marshalla...”

<https://youtu.be/RhIkoqNIIVM?si=QUeGK06bORKNOB6S>

Dori u çua në këmbë dhe më erdhi pranë dhe vazhdoi këngën:

“ O e ka synin o rrush të zie,
marshalla, marshalla..”

Mbas pak erdhi momenti që mezi priste

- Tito, në raste gëzimi, xhinsi jonë ndizet e merr flakë. Digje mo ene tina atë shaminë e beqarit se shumë e ke mbajt.

Orkestra dëgjoi thirrjen e Dorit dhe ndërroi melodi.

“ Laje mi goce laje shomin e beqaret ee..”

<https://youtu.be/QOCiEB4f8kY?si=7uDTfLaaZZSluA0U>

dhe duke na u drejtuar shtoi:

- Më takon mu Tito me e I dhonë drejtim kësoj valleje.

Nxori nga xhepi çakmakun e ja la në dorë nuses e cila i vuri flakën shamisë, ndërkohë që Dori vazhdoi këngën:

“ Digje mi goce digje shomin e beqarit ee..”

Duartrokitjet e shoqëruan këngën e tij.

- E dogjëm Dori – I thashë.
- Osht gëzim Tito. Una, prej qefit kom djeg këmishat e vjetra të gjith tironës në stadium. Xhinsi jonë e shpreh gëzimin me flakë e me zjarr.

Dori i dha gjallëri dhe bukuri dasmës. Më pas morri vallen e kënduar tiranase “ Ra Faja prej fikut.”

https://youtu.be/IkS7XJpt8rg?si=_yLM6mVc_r5QW6RB

Atë natë piu shumë, erdhi në qef dhe këndoi bashkë me shkodranët.

Ishte dasma e fundit ku mori pjesë.



Ndarja

Nuk kishin kaluar as 2 vjet nga dasma ime, kur marr vesh që gjyshi ishte shtruar në spitalin e Durrësit. Nisem me vrap për në Durrës dhe arrij në spital rreth orës 3 mbas dite. Gjyshi sa më pa i mbushi sytë me lot.

- Mos u mërzit Tito se do bohem mirë. – Më tha.

Më zuri syri që xhami i dritares së dhomës ku ishte shtruar ishte i thyer dhe dhoma ishte e ftohtë.

- Rri në krevat dhe mbulohu mirë gjysho se bën ftohë këtu.
- Po mor Tit, mos u boj merak. Hik tani, mos bohesh vonë, shko me vrap me kap trenin se je për punë nesër

Më mori për qafe , më shtrëngoi fort dhe nuk më lëshonte. Sytë i shkëlqenin po lotët nuk i dilnin. Mu duk sikur i mbante me zor që të mos prekesha unë.

- Amanet Tito, po më ndodhi gjo du që të më varrosni në majë të varrezave, aty ku duket deti.

Ishte takimi im i fundit me Dorin, gjyshin dhe shokun tim të zemrës.

Dola nga dhoma dhe në korridor takova mjekun e repartit.

- Jam nipi i Dorit – i thashë.
- Mbas operacionit, ka marë të ftohur të rëndë – më tha- por është plak i fortë, dhe qefli. Mbrëmë ja ka marrë këngës.
- Doktor, më fal por nuk mund të lini një burrë plak në një dhomë të ftohtë dhe me dritare me xhamin të thyer.
- Ke të drejtë. – Më tha. - I kemi lajmëruar, po nuk kanë ardhur akoma që ta rregullojnë.
- Po ju cfarë bëni a keni ndo pak përgjegjësi për jetën e këtyre njerëzve.

U ktheva në Tiranë por mëndja më rrinte tek gjyshi.

Të nesërmen, babai më thotë se gjyshi është rënduar dhe ai do nisej për në Durrës. Marr leje nga puna dhe nisem edhe unë. Nga stacioni i trenit shkoj direkt në spital. Hyj në dhomën ku ishte shtruar por krevati ishte bosh. Në dhomë gjeta marangozin që po vinte xhamin e dritares “killër”.

U dëgjua një zë nga krevati ngjitur.

“Ai plaku dha shpirt sot në mëngjes.”

Lotët më rrodhën pa e kuptuar. Hika me vrap nga ai vënd i mallkuar. Ai spital më kish ndarë për jetë nga gjyshi dhe shoku im i paharruar Dori.

U nisa me vrap për tek shtëpia e gjyshit. Tek hyrja ishte shpallja e vdekjes. Dera e shtëpisë qëndronte e hapur. Në dhomën e pritjes prisnin Babai dhe xhaxhai. Më morën në qafë. Xhaxhai më tha duke më përqafuar:

- Ty të kishte të veçantë. Të përmendi edhe përpara se të jepte shpirt.

Halla Landa ma dëgjoji zërin dhe hyri në dhomë dhe më përqafoi duke më thënë:

- He shpirti i hallës. Na la gjyshi.
- Ngushëllime halla. Të rrojmë e ta kujtojmë.
- Hajde me hallën ti japësh lamtumirën e fundit.

Hyra në dhomën e të vdekurit. Sa më panë, gjyshja dhe halla Vali, u ngritën në këmbë dhe më përqafulan duke qarë me dënësë. Më pas ju afrova arkivolit. Vura dorën mbi ballin e ftohtë të gjyshit dhe pa e kuptuar as vetë, lotët më rrodhën pa e kuptuar dhe sytë më shkuan tek gjyshi. Mu kujtuan fjalët e tij “ burrat nuk qajnë Tito.”

Ky kujtim ma shtoi dhimbjen dhe lotën nuk i përmbaja dot.

Me gjithë dëshirën për të qëndruar pranë gjyshit, nuk qëndrova dot gjatë në atë dhomë ku gratë që qanin ma shtonin edhe më shumë trishtimin.

U ngrita, fshiva lotët dhe hyra në dhomën e burrave. U ula edhe unë në krah të Babait dhe xhaxhait për të pritur njerëzit. Mbas tyre isha më i madhi në moshë nga burrat e familjes.

Të nesërmen u bë ceremonia e varrimit. E shoqëruam Dorin deri në lartësinë e kodrës të varrezave të Durrësit, fuke plotësuar kështu edhe dëshirën e tij e fundit.

Shokë të ngushtë kam patur në jetë, por Dori ishte shoku im i ngushtë i cili më deshte më shumë nga të gjithë të tjerët. Kujtimi i tij më mbetet i gjallë edhe tani që po shkruaj këto rjeshta dhe do ta kujtoj deri sa të kem jetë.

*Prehet aty në majën e kodrës së varrezave të Durrësit
dhe më duket sikur shikimi i shpirtit të tij arrin deri
matanë detit....*

Epilog.

Ky libër është bazuar në kujtimet e mia direkte për gjyshin tim Teodorin që më edukoj në mënyrën më efikase dhe më natyrale që mund të ketë: duke më konsideruar dhe trajtuar tamam si shok. Ishte pikërisht kjo mënyrë e cila mi mbajti të freskëta këto kujtime. Dori më thoshte “ Ta dush vendin tënd dhe qytetin ku ke lindur dhe je rritur. Ti duash dhe respektosh njerëzit e mirë dhe Tironcit e ndershëm.”

Këto fjalë të tijat janë bindëse edhe sepse ai ishte vetë një njeri i tillë.

Ishte pikërisht kujtimi i gjyshit që më bëri të shkruhem në shoqatën e Tiranës 12 vjet më parë.

E ndiej që kam mare shumë nga karakteri i tij ose si thoshte ai nga “xhinsi”

Në 24 Nëntor të këtij viti, në festën e ngritjes së flamurit në Tironë, më arrin në celular një përshëndetje nga shoku im dhe kryetari i shoqatës Tirana i ndjeri Arben Tafaj cili u nda prej nesh aksidentalisht vetëm pak kohë më parë më 3 dhjetor 2024

Po e mbyll këtë libër me mesazhin e tij.

<https://www.facebook.com/share/v/18HJo4Bx5j/>

